



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:072505

Datë: 16.02.2023

Numri i dokumentit: 03987132

A.nr.867/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, me prezencën e përkthyesit gjyqësor B.K., në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses P.F., nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me bazën juridike: anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 16.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses P.F., nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve.

II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve data 21.02.2022 dhe çështja i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje organit të paditur.

A r s y e t i m i

Paditësja me padinë e datës 12.04.2022 ka kërkuar anulimin e vendimit të datës 21.04.2022 dhe paditëses ti njihet e drejta në pensionin e paaftësisë së përhershme. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se kërkonte që të bëhet edhe njëherë rishqyrtimi i lëndës pranë organit administrativ.

E paditura në përgjigje në padi ka kontestuar në tersi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke kërkuar që të refuzohet në tersi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative me prezencën e paditëses dhe në mungesën e të paditurës e ftuar me ftesë të rregullt gjyqësore. Gjykata për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë dhe gjendjen e plotë të fakteve, për të vendosur në këtë çështje juridike, në seancën e datës 16.02.2023 ka bërë administrimin e provave si: vendim i dt. 13.01.2020, fletë lëshim i dt.30.05.2013, raport nga konsulta mjekësore dt. 05.04.2022, 06.04.2022, 05.04.2022, 07.04.2022, 05.04.2022, 07.04.2020, 05.04.2020, 18.11.2022, 25.11.2022, 09.01.2023, 14.07.2015, raport me epikrizë nr.regj.2399, echocoriografia nga Spitali Rajonal – Prizren i dt.07.04.2022, vendim i dt.21.02.2022, 05.11.2021, vendim i dt.30.09.2013, ankesë e dt. 05.01.2021, vendim i dt.13.01.2020,

17.11.2016, 10.11.2020, raport mjekësor i dt.14.09.2021, 02.11.2019,12.11.2016, vlerësim i Komisionit mjekësor i dt. 18.12.2013, 14.11.2016, 09.11.2020, 04.11.2021, 10.01.2020, 25.01.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e datës 21.02.2022 refuzohet ankesa e këtu paditëses si e pa bazuar.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e të paditurës ka inicuar konflikt administrativ sipas padisë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, i njëjti nuk përmban elementet nga neni 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ligj ky i aplikueshëm në periudhën e ankimimit dhe shqyrtimit të çështjes pran organit administrativ. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. I njëjti bën një përshkrim të rrjedhës së procedurës duke potencuar se organi i shkallës së dytë ka shqyrtuar në tersi shkresat e lëndës në seancën e datës 25.01.2022, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës dhe vlerësimin e komisionit të shkallës së parë, në përputhje me nenin 9 për PAK dhe ka konstatuar se nuk ka dokumentacioni mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj komisioni mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj. Në vendimin e atakuar nuk jepet arsyetim konkret për pretendimin e paditëses, pra nuk përmendet asnjë provë e shqyrtuar në bazë të së cilës është vërtetuar ndonjë fakt, me cilat prova i ka konstatuar faktet vendimtare dhe mbi cilat dispozita ligjore është mbështetur për të ardhur te konstatimi se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues të pensionit për persona me pa aftësi të përhershme.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm se ankuesi, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues i pensionit.

E paditura nuk ka bërë fare arsyetim as në vendimin e shkallës së parë dhe as me vendimin e shkallës së dytë, se nga cila bazë paditësja nuk i plotëson kriteret për pensioni e personave me pa aftësi të përhershëm.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, pasi që nuk ka prova se e paditura ka vërtetuar gjendjen sipas provave që kërkohen nga dispozitat ligjore.

Po ashtu gjykata nga shkresat e lëndës ka konstatuar se me vendimin e datës 10.11.2020 paditëses i njihet e drejta në pension të paaftësisë së përhershme nga data 02.10.2020 dhe ftohet në rivlerësim pas një viti, me vendimin e datës 13.01.2020 paditëses i njihet e drejta në pension të paaftësisë së përhershme nga data 02.10.2019 dhe ftohet në rivlerësim pas një viti. Po ashtu kjo e drejtë i është njohur edhe me vendimin e datës 17.11.2016, ku paditëses i njihet kjo e drejtë nga data 29.09.2016, duke e ftuar në rivlerësim pas tri vitesh, andaj përballë kësaj gjendje të konstatuar nga vet e paditura e cila konstaton paaftësinë të këtu paditëses, e njëjta nuk ka arritur të dëshmoj para gjykatës vendimin mbi refuzimin e kësaj të drejte, kur nga vet e paditura i është njohur fillimisht.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe të ketë parasysh provat në shkresat e lëndës, dhe po ashtu faktin se nga vet e paditura dy herë radhazi i është njohur e drejta në pension këtu paditëses dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendosë në kuptim të nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.867/2022: Data:16.02.2023

Sekretare Juridike
Nazife Sheholli

Gjyqtare
Liridona Ajeti Kajtazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.